

ECDC INFORMACION SHËNDETËSOR

Informacion rreth sëmundjes së legjionarëve për menaxherët e akomodimit turistik

Përjashtimi i përgjegjësisë: Kjo fletëpalosje informative shërben vetëm për qëllime informative të përgjithshme. Kontaktoni autoritetet përgjegjëse në vendin tuaj për udhëzime dhe informacion lidhur me legjislacionin specifik të shtetit.

Çfarë është sëmundja e legjionarëve?

Sfondi

Çdo vit më shumë se 1000 udhëtarë raportohet të kenë marrë sëmundjen e legjionarëve*. Megjithatë, rreziku i sëmundjes së legjionarëve në akomodim gjatë udhëtimit mund të zvogëlohet. Ky fletëpalosje përmban informacion për pronarët ose menaxherët e akomodimit turistik (p.sh. hotelet, apartamentet, vendet e kampingut).

Çfarë është sëmundja e legjionarëve?

Sëmundja e legjionarëve është një lloj i rëndë pneumonie (infeksion i mushkërive) i shkaktuar nga bakteri *Legionella*. Rreth 5-10% e pacientëve vdesin. Jo të gjithë ata që janë ekspozuar ndaj bakterit *Legionella* do të sëmurin. Njerëzit me sëmundje të tjera në sfond, duhanpirësit dhe njerëzit e moshuar janë në një rrezik më të lartë të sëmurin nga *Legionella*. Simptomat fillojnë zakonisht midis dy dhe dhjetë ditëve pas infektimit, por në raste të rralla mund të kalojnë deri në tri javë para paraqitjes së simptomave.

Sëmundja zakonisht fillon me ethe, ftohje, dhimbje koke dhe dhimbje muskujsh. Kjo pasohet nga një kollë e thatë dhe vështirësi në frymëmarrje që mund të përparojnë në pneumoni të rëndë. Rreth një e treta e pacientëve gjithashtu kanë diarre ose të vjella dhe rreth gjysma e tyre janë konfuzë ose në kllapi. Shumica e pacientëve duhet të shtrohen në spital dhe të trajtohen me antibiotikë të përshtatshëm. Diagnoza kërkon teste specifike laboratorike. Diagnoza bëhet shpesh pasi udhëtari të jetë kthyer në shtëpi.

Si merret sëmundja e legjionarëve?

Sëmundja e legjionarëve merret duke thithur pika mikroskopike uji (aerosolë) që e përmbajnë bakterin *Legionella*. Këto baktere jetojnë në ujë dhe shumëzohen kur kushtet janë të përshtatshme; për shembull, në ujin e ndenjtur në sisteme ujore të bëra nga njeriu në 20°C deri në 50°C. Aerosolët me *Legionella* mund të prodhohen, për shembull, kur hapet një rubinet ose dush, në flluskat që dalin nga uji në një pishinë spa ose në disa sisteme ajri të kondicionuar.

* Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve. Sëmundja e legjionarëve në Evropë, 2014. Stokholm: ECDC; 2016. E disponueshme nga <http://ecdc.europa.eu/en/publications/Publications/legionnaires-disease-europe-2014.pdf>

A është akomodimi burimi i infeksionit?

Fakti që një person me sëmundjen e legjionarëve ka qëndruar në një akomodim specifik nuk do të thotë domosdo se pacienti e ka marrë infeksionin atje. Ai ose ajo mund ta ketë marrë infeksionin nga një sërë vendesh të ndryshme. Sidoqoftë, kur dy ose më shumë pacientë kanë qëndruar në të njëjtin akomodim, veçanërisht brenda një periudhe të shkurtër kohore, ka më shumë të ngjarë që akomodimi të jetë burimi i infeksionit. Në këtë situatë, ka nevojë për hetime urgjente në akomodim.

Si menaxher akomodimi turistik, ju duhet të jeni i vetëdijshëm për rrezikun e sëmundjes së legjionarëve dhe të merrni masa për ta zvogëluar këtë rrezik sa më shumë që të jetë e mundur.

Cilat janë zonat e rrezikshme në akomodimin turistik?

Rreziku i infektimit ekziston kudo qoftë që mund të krijohen pika uji (aerosolë). Disa shembuj janë:

- Dushet dhe rubinetet
- Pishinat spa/me vorbull
- Kullat ftohëse dhe kondensatorët avullues që përdoren për ajrin e kondicionuar
- Shatërvanët zbukurues, veçanërisht në ambientet e brendshme
- Enët për ekspozimin dhe lagështimin e ushqimit dhe pajisjet avulluese të tjera
- Sistemet ujore të zorrëve të kopshtit që përdoren për ujitjen e bimëve

Ku mund të mbijetojnë dhe të shumëzohen bakteret *Legionella*?

- Në ujë në temperatura midis 20°C dhe 50°C
- Në depozita ose çisterna me ujë të nxehtë dhe të ftohtë
- Në tubacione, ku rrjedh pak ujë ose nuk rrjedh ujë fare (duke përfshirë dhomat e pabanuara)
- Në jargën (biofilmin) dhe papastërtinë që ndodhet në sipërfaqet e brendshme të tubave dhe rezervuarëve
- Në gomë dhe fibrat natyrale në makinat larëse dhe guarnicione
- Në ngrohësit e ujit dhe rezervuarët e uji të nxehtë
- Në gurin e ujit dhe korrozion në tuba, dushe dhe rubinete.

Këto kushte inkurajojnë shumëzimin e bakterit *Legionella* dhe rrisin rrezikun e infektimit për vizitorët dhe stafin.

Si ta monitorojmë sëmundjen e legjionarëve?

Rrjeti Evropian i Mbikëqyrjes së Sëmundjes së Legjionarëve (ELDSNet) kryen mbikëqyrjen e sëmundjes së legjionarëve. Ai koordinohet nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC). Rrjeti përbëhet nga epidemiologë dhe mikrobiologë të emëruar nga autoritetet kombëtare të shëndetit publik në BE dhe shumë vende anembanë botës. Ky rrjet ndan informacion midis vendeve ku njerëzit janë sëmurë dhe vendeve ku mund të ketë ndodhur infektimi i tyre. Ky rrjet ka edhe procedura për të informuar operatorët turistikë lidhur me klasterët e rasteve. Ju mund ta zvogëloni këtë rrezik duke pasur një plan kontrolli për bakterin *Legionella*.

Çfarë mund të bëj si menaxher akomodimi turistik për të parandaluar infektimi i mysafirëve të mi me sëmundjen e legjionarëve?

Zvogëlimi i rrezikut: një plan prej 15 pikësh për të zvogëluar rrezikun nga *Legionella*

Rreziku i sëmundjes së legjionarëve mund të minimizohet.

Hotelierëve dhe pronarëve të tjerë të akomodimit u rekomandohet të ndjekin planin prej 15 pikësh për të zvogëluar rrezikun nga *Legionella*:

1. Caktoni një person përgjegjës për kontrollin e bakterit *Legionella*.

2. Sigurohuni që personi i përmendur ka trajnim dhe përvojë të mjaftueshme për të kryer këtë funksion me kompetencë dhe që stafi është trajnuar në mënyrë që të jetë ndërgjegjes për rëndësinë e rolit të vet në kontrollin e bakterit *Legionella*.
3. Sigurohuni që uji i ngrohtë të jetë i ngrohtë dhe të qarkullojë në çdo kohë: 50°C - 60°C (tepër e nxehtë për të mbajtur duart në ujë për më shumë se disa sekonda) në tërë sistemin e ujit të ngrohtë.
4. Mbani ujin e ftohtë të ftohtë në çdo kohë. Uji duhet të mbahet në temperatura nën 20°C në tërë sistemin në të gjitha dhe në të gjitha daljet e ujit (kjo mund të jetë e pamundshme kur temperatura e ambientit është e lartë, por duhet të bëhet çdo përpjekje për të siguruar që uji që hyn dhe ruhet në ambiente të mbetet sa më i ftohtë që të jetë e mundur).
5. Hapni të gjitha rubinetet dhe dushet në dhomat e mysafirëve dhe në zona të tjera për disa minuta në mënyrë që uji të qarkullojë (derisa të arrijë temperaturat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4) së paku një herë në javë në qoftë se dhomat janë të pabanuara dhe gjithmonë para marrjes së dhomës në përdorim nga një mysafir.
6. Mbani dushet dhe rubinetet të pastra dhe pa gurë uji.
7. Pastroni dhe dezinfektoni rregullisht kullat ftohëse dhe tubat e ndërlidhur që përdoren në sistemet e ajrit të kondicionuar - së paku dy herë në vit.
8. Pastroni, kulloni dhe dezinfektoni ngrohësit e ujit (kaloriferët) një herë në vit.
9. Dezinfektoni sistemin e ujit të ngrohtë me klor të koncentruar (50mg/l) për 2–4 orë pas kryerjes së punimeve në sistem dhe ngrohësit e ujit dhe para fillimit të çdo sezoni.
10. Pastroni dhe dezinfektoni rregullisht të gjithë filtrat e ujit, sipas udhëzimeve të prodhuesit, së paku çdo 1-3 muaj.
11. Inspektoni rezervuarët e ujit, kullat ftohëse dhe tubat e dukshëm çdo muaj. Sigurohuni që të gjitha mbulesat të jenë të paprekura dhe të vendosura fort.
12. Kontrolloni pjesën e brendshme të rezervuarëve të ujit të ftohtë së paku një herë në vit, dezinfektojini me klor 50mg/l dhe pastrojini në qoftë se ka një sediment brenda ose janë të papastër.
13. Gjatë modifikimit të sistemit ose vendosjes së instalimeve të reja, sigurohuni që nuk ka tuba, ku uji rrjedh me ndërprerje ose nuk rrjedh fare, dhe dezinfektoni sistemin pas çdo punimi.
14. Nëse ekziston një pishinë spa (e njohur edhe si pishinë me vorbull, jakuzi ose banjë spa), sigurohuni që:
 - ajo trajtohet vazhdimisht me 2-3mg/l klor ose brom dhe nivelet e pH-së monitorohen së paku tri herë në ditë;
 - së paku gjysma e ujit zëvendësohet çdo ditë;
 - filtrat e rërës lahen çdo ditë;
 - tërë sistemi pastrohet dhe dezinfektohet një herë në javë.
15. Mbani shënime ditore për të gjitha vlerat e trajtimit të ujit, siç janë temperatura, pH dhe koncentrimet e klorit dhe sigurohuni që ato të kontrollohen rregullisht nga menaxheri.

Këshilla të mëtejshme rreth kontrolleve specifike mund të kërkohen nga ekspertët e kësaj fushe. Ata mund të kryejnë një vlerësim të plotë të rrezikut në vendin e akomodimit. Autoritetet lokale të shëndetit publik mund t'ju këshillojnë më tej.

Testimi mjedisor për *Legionella*

Testimi për *Legionella* është një mjet i dobishëm, por vetëm nëse kryhet nga staf i trajnuar, i cili vlerëson njëkohësisht edhe sistemin e ujit. Për më tepër, mostrat e ujit duhet të ekzaminohen nga laboratorët e akredituar për testimin e bakterit *Legionella* (p.sh. nga UKAS, ISSO, ACCREDIA ose organet kombëtare ekuivalente). Një rezultat negativ i testit nuk do të thotë domosdo se vendi i akomodimit është i pastër nga *Legionella* ose se nuk ka asnjë rrezik.

Si mund të mësoj më shumë?

Në faqen e internetit ELDSNet * *, ju mund të gjeni më shumë informacion, si edhe një link për "Udhëzimet teknike evropiane për parandalimin, kontrollin dhe hetimin e infeksioneve të shkaktuara nga bakteri *Legionella*, qershor 2017".

* <https://ecdc.europa.eu/en/about-us/partnerships-and-networks/disease-and-laboratory-networks/eldsnet>